



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite  
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA  
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT PËR PERSONA TE RIATDHESUAR

### Thirrje per Aplikim

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) shpallin thirrjen për personat e riatdhesuar, **të cilët kanë paraqitur Idet e tyre te biznesit gjatë vitit 2017** në zyrat për kthim dhe Komunitete që të marrin **aplikacionet e Biznes Planeve** në zyrat përkates të Punësimit ku do t'u mundesohet të aplikojnë në një proces të hapur dhe konkurrues në mes tyre për mbështetje për zhvillimin e biznesit në kuadër të Programit të Vetëpunësimit të APRK-së. Kandidatet të cilët kualifikohen pas plotësimit të aplikacioneve ftohen që të bëjnë dorëzime planeve të tyre në të njëjtat zyre ku kanë marr aplikacionet. Programi i Vetë-punësimit financohet nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

### Rreth Programit të Vetëpunësimit

Qëllimi i Programit të Vetëpunësimit është të mbështesë personat e riatdhesuar në krijimin e planeve të realizueshme të biznesit që janë në gjendje t'i mbijetojnë tregut konkurrues duke promovuar vetë-punësimin si masë aktive e tregut të punës. Mbështetja me grante do të ofroj paisje për realizimin e Planit të biznesit. Programi në vazhdimësi do asistoj në zhvillimin e e biznesit përmes këshillimit për t'i ndihmuar personat e riatdhesuar e të papunë me kualifikime të orientuar për të qenë të suksesshëm në fushën e zgjedhur. Programi i prezentuar i Vetëpunësimit është program konkurrues për të garantuar kthimin më të lartë të mundshëm të investimit. Procesi i përzgjedhjes ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të drejtë dhe t'i mbështesë idetë dhe planet më të mira të biznesit që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

## **Programi do të zbatohet si në vijim :**

- **Faza e parë** do ju mundesohet të aplikojnë vetem personave qe tashme kanë dorezuar idetë tyre te biznesit ne zyrat per kthim dhe komunitete gjatë vitit 2017, mirepo nuk jane shqyrtuar. Programi do t'u jap mundesi ketyre personave që te konkurojnë në mes tyre duke aplikuar me Plane te biznesit sipas udhezimeve operacionale të MPMS/APRK-së në zyrën me të afert të punësimit.Për fazen e parë kane drejt aplikimi vetem personat në listën,e cila i bashkangjitet shpalljes se brendshme per aplikim ne secilen komunë përkatëse.
- **Gjatë vitit 2018**,në thirrjen e dytë do ju mundesohet të aplikojnë të gjithë personat e riatdhesuar të pa punë ,të cilët kualifikohen sipas rregullores për Riintegrim.Thirrjet për aplikim do të shpallen në zyrat komunale të Punësimit në kuader të APRK-së.

## **Mbështetja nga programit**

Qëllimi i Programit është që të sigurojë mbështetje hap-pas-hapi për idetë dhe planet e biznesit që kanë mundësinë më të madhe të arrijnë sukses dhe të përballen me barriera të ndryshme të tregut.

## **Sektorët ekonomik me prioritet dhe të pranueshëm**

**Të gjitha Biznes Idetë nga secili sektor ekonomik mund të aplikojnë për Programin.**

Aktivitetet e biznesit që kanë prioritet duhet të jenë në gjashtë sektorët e mëposhtëm ekonomikë , të përzgjedhura nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) , që kanë potencial më të lartë për rritje ekonomike në Kosovë, të identifikuar nëpërmjet këtij vlerësimi në bazë të mjedisit të sektorit privat në rajon, përkatësisht :

- Përpunimi i ushqimit dhe industria e paketimit, me fokus në përpunimin e mishit;
- TIK krahas me kontraktimin e jashtëm të proceseve të Biznesit dhe sektori i qendrave të mbështetjes për konsumatorë;
- Ndertimtaria;
- Industria e përpunimit të metalit;
- Industria e tekstilit;
- Industria e përpunimit të drurit dhe bizneset pyjore.

Luteni të shihni listën e KLASIFIKIMIT TE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE: [http://ask.rks-gov.net/media/2474/klasifikimi-i-veprimtarive-ekonomike-neca-rev\\_-2.pdf](http://ask.rks-gov.net/media/2474/klasifikimi-i-veprimtarive-ekonomike-neca-rev_-2.pdf)

### **Megjithatë, Idetë e biznesit të pa pranueshme për të marrë pjesë në Program janë:**

- veprimtaritë me patundshmëri, lizing;
- veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve dhe veprimtaritë që përfshijnë bixhozin;
- prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit dhe rakisë;
- prodhimi i produkteve të duhanit;
- prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
- prodhimi që përdor teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (si ndotje të ajrit, ujit, tokës etj.);
- bizneset joformale;
- aktivitete biznesore nën sektorët e tregëtisë;

### **Aplikantët e pranueshëm**

Të gjithë aplikantët e interesuar për tu kualifikuar për aplikim duhet të janë pjesë e listës së bashkangjitur në secilin komunë. Kjo listë sigurohet nga të dhënat e MPB/DRPR dhe përmban vetëm personat që kanë dorëzuar biznes ide në zyrat përkatëse komunale për kthim dhe komunitete. Asnjë aplikant jashtë listës në komunën përkatëse nuk do të konsiderohet për shqyrtimin e kërkesës për fazën e parë.

Kandidatët e kualifikuar dhe pjesëmarrës në Program **duhet të janë persona e riatdhesuar të regjistruar si të papunë në Zyrat e Punësimit (ZP) si dhe duhet të kenë kryer Trajnimin “Fillo Biznesin Tuaj” në Qendren e Aftësisë Profesionale**, në kohën e aplikimit. Këshilltarët për punësim do të sigurojnë sesione këshillimi gjatë të cilës përcaktohet nëse personi i riatdhesuar i pa punë do të aplikojë në këtë Program. Personat e riatdhesuar të papunë për biznes planet që nuk aprovohen nga Programi i Vetëpunësimit mund të aplikojnë për skema tjera të trajnimit dhe Punësimit në kuadër të masave aktive.

Personave të papunë të grupeve në vijim do t'u jepet prioritet.

- të papunët afatgjatë (më shumë se 12 muaj);
- të rinjtë (18-29 vjeç);
- gratë;
- të mbijetuarit e dhunës në baza gjinore;
- përfitues të ndihmës sociale;
- personat e vetëm, me një ose më shumë anëtar që varen nga ai/ajo (prindër vetëushqyes);
- personat nga viset rurale;
- personat me aftësi të kufizuara;
- grupet e pakicave etnike.

Personat që nuk kualifikohen për aplikim janë ata persona të cilët:

- nuk janë të regjistruar në ZP;
- nuk kanë perfunduar trajnimin në QAP (në kohën e aplikimit në ZKKK)
- nuk janë persona të riatdhesuar;
- kanë perfituar me heret plan biznesi ose masa tjera aktive të punësimit
- janë në konflikt të interesit me palë të përfshira dhe vendimmarrës në Program;
- janë punëkërkues që kanë perfituar nga masa të tjera aktive të tregut të punës gjatë 12 muajve të mëparshëm kalendarik (nga data e aplikimit për Ide të Biznesit).
- Personat që kanë biznes të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.

### **Mbështetja financiare**

Programi i Vetëpunësimit do të sigurojë ndihmë në grante në vlerë **deri 3,000 Euro për çdo plan të biznesit të zhvilluar me sukses** që është miratuar në kuadër të procesit të përzgjedhjes ku do ofrohet mbështetje sipas planit të biznesit.

*Aplikantët që sigurojnë kontribut financiar ekuivalent me së paku 20 për qind të financimit të kërkuar nga granti, do të marrin pikë shtesë (3 pikë prej 100 në total) nga vlerësimi i planeve të biznesit. Nëse kontributi është më i vogël se 20 për qind, nuk do të jepen pikë shtesë.*

Aplikantët e miratuar mund të planifikojnë për financim shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, lizing, grante, etj.) në dispozicion në Kosovë përmes institucioneve financiare ose programeve të financuara nga donatorët. Instrumentet e tilla rekomandohen për zgjerim të mëtejshëm të biznesit që nuk është mbuluar nga plani i biznesit, me mbështetje përmes grantit të këtij Programi.

Përparësi do t'u jepet aplikantëve me ide unike të biznesit (të papërsëritura tek aplikantët tjerë) ose që ofrojnë produkte/shërbime të reja, përdorin zgjidhje teknike dhe teknologji të reja prodhimi dhe/ose që kursejnë energji elektrike, përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë, si dhe biznese që krijojnë më shumë se 3 vende pune (vetëm për të papunët e regjistruar)

### **Kriteret e vlerësimit të Biznes Planeve**

Çdo plan i biznesit vlerësohet nga dy ekspertë të pavarur. Secili ekspert vlerëson planin e biznesit dhe nuk diskuton vlerësimet e tij/saj me të tjerët. Nëse ndryshimi ndërmjet rezultateve të dy ekspertëve është më i madh se 15 pikë, plani i biznesit i jepet një tjetër ekspert për një vlerësim të tretë. Rezultati përfundimtar për këtë plan të biznesit është rezultati mesatar i dy vlerësimeve. Ekspertët e vlerësimit bëjnë vlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në bazë të 2 (dy) kriterëve: të përshkruara sipas Formularit të vlerësimit të planit të biznesit

- **Kriteret e realizueshmërisë së planit të biznesit**

Rezultati maksimal është 90 pikë, dhe matet sipas kriterëve të mëposhtme:

- Realizueshmëria financiare e biznesit;
- Resurset në dispozicion për biznesin – objekti, pajisjet, furnizimet dhe stafi;
- Njohja e llojit përkatës të biznesit;
- Vlerësimi i tregut.

### **Shpenzimet e pranueshme**

Shpenzimet e pranueshme që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të shfrytëzohen për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si dhe softuerit dhe aseteve të tjera jo të prekshme;

Shpenzimet e papranueshme që nuk mund të mbulohen nga granti përfshijnë:

- blerjen e patundshmërive (tokë, ndërtesa, etj.)
- blerjen e mjeteve transportuese;
- çdo shpenzim që nuk është i lidhur me biznesin e propozuar;
- shpenzimet e bëra para lidhjes së kontratës për grantin.
- blerja e makinerive dhe pajisjeve të tjera të përdorura.
- Renovimin, ndertimin e objekteve.

Shpenzimet e papranueshme në kuadër të grantit mund të mbulohen nga kontributi personal i aplikantit me deshmi përkatëse. Të gjitha shpenzimet e tjera të rëndomta dhe të domosdoshme për biznesin do të mbulohen nga aplikanti.

### **Si të aplikoni**

Të gjithë personat e interesuar që plotësojnë kushtet për aplikim të kompletojnë **Formularin e aplikimit për plan të biznesit** dhe ta dorëzojnë atë në Zyrën e Punësimit ku ai/ajo është i/e regjistruar, **në një origjinal dhe dy kopje të tjera identike**, në shqip apo serbisht. Aplikantët janë të obliguar të sigurojnë si bashkëlidhje në *Formularin e Aplikimit CV-në e tyre dhe* të gjitha dokumentet që dëshmojnë shkollimin, certifikaten e Trajnimit ne Qendren e Aftesimit profesional, kualifikimin dhe përvojën e tyre që përputhet me idenë e paraqitur të biznesit.

Aplikimi për Plan të biznesit mund të dorëzohet **në Zyrën me të afërt të Punësimit ku aplikuesi/ja është regjistruar si i/e papunë**. Formulari i plotësuar i Aplikimit me dokumentet e bashkëlidhura duhet të dorëzohet personalisht në Zyrën përkatëse të Punësimit brenda orarit të punës të ZP-së.

Çdo aplikacion i dërguar i pa plotësuar me dokumentacion perkates dhe pas afatit të fundit të shpallur konsiderohet i pavlefshëm.

Data e fundit e dorëzimit të aplikimeve është 26 shkurt 2018, në orën 16:00.

Secili aplikant mund të aplikojë me vetëm një plan të biznesit (Një anëtar për familje).

### **Informata të tjera**

Informata shtesë dhe Formulari i Aplikimit mund të gjenden në [www.mpms.rks-gov.net](http://www.mpms.rks-gov.net) dhe <http://aprk.rks-gov.net/> dhe secilën Zyre të punësimit në Kosovë.

Ne rast se keni pyetje shtesë për programin e Vetëpunësimit, ju lutem kontaktoni Zyrën e UNDP, nëpërmjet postës elektronike: [almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org).

### **Data të rëndësishme**

- Shpallja e thirrjes për aplikim: **22 Janar 2018**
- Sesionet informuese në Zyra të Punësimit: **Janar-Shkurt 2018**
- Afati fundit për dorëzimin e Biznes Planeve: **26 shkurt 2018**
- Intervista me kandidatët: **10 – 15 Mars 2018**
- Shpallja e rezultateve finale: **20 Mars 2018**